



Prishtinë: 29.03.2018
Kodi i ZRRE-së: V_964_2018

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_1605_08_17**;
- Ankesa e konsumatorit e datës **18.09.2017**.

në seancën e mbajtur më datë **29.03.2018**, nxori këtë:

V E N D I M

- I **REFUZOHET** ankesa e konsumatorit N. G, nga Prishtina me shifër DPR 59712 si e pa bazuar.
- II **MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. **ZRRE/DMK_V_1605_08_17** i datës 22.08.2017.

A r s y e t i m

Zyra e Rregullatorit për Energji me datë 03.11.2017 ka pranuar ankesën e parashtruar nga J.N. në emër të N.G., i cili ka kundërshtuar vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE si vendim i shkallës së parë. Konsumatori në ankesën e tij ka theksuar se ka paguar rregullisht faturat e energjisë elektrike ashtu siç inkasanti i ka sjellë, pra gabimi ka qenë i inkasantit dhe se nëse nuk do bëheshin pagesat e energjisë elektrike atëherë do të shkyçej nga rrjeti elektrik. Konsumatori ka theksuar se inkasanti i ke theksuar se nuk ka borxhe të energjisë elektrike dhe se askush në fshat nuk ka kësi borxhi të energjisë elektrike. Konsumatori ka theksuar se ajo nuk di si të paguaj gjithë atë borxh të energjisë elektrike pasi nuk e ka shpenzuar.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 29.03.2018 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuara nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve, dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejt dhe i bazuar në prova konkrete.

Bordi i ZRRE-së, ka analizuar dhe shqyrtuar me kujdes të gjitha pretendimet ankimore të konsumatorit të theksuara në ankesë, por që nuk ka vërtetuar me asnjë element se konsumatori është i dëmtuar dhe ngarkuar me ndonjë vlerë financiare më tepër se sa shpenzimi i energjisë elektrike të bërë në ketë pikë matëse, pasi që edhe pagesat e bëra nga konsumatori në shifrën tjetër janë bartur te shifra e konsumatorit DPR - 59712.

Sa i përket pikës së kundërshtimit të konsumatorit rreth pagesës së bërë nga konsumatori ashtu siç i ka sjell inkasanti, Bordi ka analizuar edhe të gjitha konstatimet e theksuara nga shkalla e parë lidhur



me faturat e energjisë elektrike të faturuar te konsumatori dhe pagesat e bëra nga konsumatori dhe ka vërejtur se shifra e konsumatorit DPR – 59712 është e regjistruar në emër të N. G. dhe se kjo shifër ka filluar të faturohet që nga pas lufta dhe vazhdon të faturohet. Bordi i ZRRE-së ka vërejtur se konsumatori me shifrën DPR – 59712 ka filluar të faturohet me faturim pa matje/paushall që nga periudha 08/2002 e deri më 12/2009, dhe se nga periudha 01/2010 ka filluar të faturohet me matje, si dhe që nga momenti kur konsumatori ka filluar të faturohet me matje ai ka bërë pagesat me rregull të faturave të energjisë elektrike në këtë shifër. Gjithashtu Bordi i ZRRE-së ka analizuar edhe transaksionet e konsumatorit të shifrës DPR – 90052644 dhe ka vërejtur se kjo shifër është e regjistruar në emër të N. G. dhe se ka filluar të faturohet që prej periudhës 05/2009 deri më 17.12.2009, dhe se borxhi i përgjithshëm i energjisë elektrike në këtë shifër ka qenë 90.66€, ndërsa pagesat e bëra nga konsumatori në këtë shifër ka qenë 91.40€.

Sa i përket pikës së tjetër të kundërshtimit lidhur me atë që ka qenë gabimi i punëtorëve të KEK/KEDS për këtë faturim, Bordi i ZRRE-së gjatë analizimit të shkresave të lëndës konstaton se konsumatori me shifër DPR – 59712 ka pasur në funksion njehsorin nr.1982887 prej periudhës 01/2010 e deri më 10/2014, ndërsa njehsori elektrik nr.1982887 ka qenë i regjistruar edhe në shifrën DPR – 90052644 prej periudhës 05/2009 e deri më 12/2009, e që të dy shifrat kanë qenë të regjistruara në emër të N.G., dhe se në të dy shifrat konsumatori është faturuar nga KEK-u atë kohë dhe ka paguar faturat e energjisë elektrike. Pra Bordi i ZRRE-së konstaton se ka qenë gabim i KEK rreth faturimit të dyfishtë dhe se për shkak të këtij gabimi të bërë të KEK, KESCO me datë 05.01.2017 ka bërë rregullimin e këtyre shifrave të konsumatorit dhe se të gjitha pagesat e bëra në shifrën DPR – 90052644 në vlerë prej -91.40€ i ka bartur te shifra DPR – 59712.

Bordi i ZRRE, gjithashtu ka konstatuar se konsumatori në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejt dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar pa ofruar prova të arsyeshme.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 29.03.2018 pas analizimit të krejt asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimet të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i Rregullatorit:

Arsim Janova, u.d. kryesues

Besim Sejfiqaj, anëtar

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Konsumatorit N. G. (parashtruesit J. N.) dhe
- KESCO-së, dhe
- Arkivit të ZRRE-së